



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:261092

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05299020

KPPP.nr. 1942/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.Sh.Z.T “Argjendi” me seli në Vushtri, me bazë përmbarimi sipas dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbarim, jashtë seancës, me datë 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë dhe debitorit N.Sh.Z.T “Argjendi” me seli në Vushtri.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtri, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me Aktvendimin CP.nr. 180/19, të datës 26.06.2019, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit N.Sh.Z.T “Argjendi” me seli në Mitrovicë, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej EUR 202.70 sipas dokumentit të besueshëm. Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur kundërshtim, ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega

Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr. 180/19, të datës 18.07.2019, e ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e debitorit. Debitori ndaj aktvendimit në fjalë ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac.nr. 2080/20, të datës 11.01.2021, e ka refuzuar ankesën e debitorit si të pabazuar ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Pasi që aktvendimi mbi lejimin e përmbarrimit ka marrë formë të prerë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr. 180/19, të datës 12.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarrimore, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbarrimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Mitrovicë, Dega Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarrimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarrimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarrueshëm për përmbarrimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt zbatimin e përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi

mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, pasi që urdhri mbi lejimin e përmbarimit ka marr formë të prerë. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit i cili ka marrë formë të prerë nga gjykata si organ përmbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore Mitrovicë, Dega Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1942/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.